

RREGULLORE E BRENDSHME

NOTIFIKIMI NË CEN/CENELEC I STANDARDEVE TË ADOPTUARA

Bazuar në ligjin nr.9870, datë 4.2.2008, “Për Standardizimin”, i amenduar, miratohet rregullorja “Notifikimi në CEN dhe CENELEC i standardeve të adoptuara si Standarde Shqiptare”, sipas tekstit të mëposhtëm:

1. Objekti

Objekt i kësaj Rregulloreje është të sigurojë plotësimin e detyrimeve për notifikimin e gjitha standardeve Europiane të adoptuara si Standarde Shqiptare në CEN dhe CENELEC.

2. Qëllimi

Kjo rregullore hartohet me qëllim zbatimin e të gjitha detyrimeve që DPS ka si anëtare (Affiliate) në CEN dhe CENELEC dhe plotësimin e kushteve për t’u bërë anëtare me të drejta të plota në këto organizma. Në këtë rregullore shprehen në mënyrë të detajuar zbatimi i të gjitha detyrimeve të DPS-së, duke filluar që nga përgatitja e materialit për notifikim, formati i notifikimit për secilin organizëm, koha e notifikimit, përdorimi i programit përkatës të notifikimit (i-projex për CEN) dhe gjithshka të nevojshme për këtë notifikim.

3. Referencat

- Ligji Nr.9870, dt. 04.02.2008 “Për Standardizimin”, i ndryshuar
- Rregullorja e Brendshme e CEN-CENELEC Pjesa 2: “Rregulla të përbashkëta për Punën e Standardizimit”, publikim i vitit 2011;
- Kushti 2 (c) : rregulloret e brendshme të DPS-së të reflektojnë plotësisht kërkesat e dhëna në Rregulloren e Brendshme të CEN-CENELEC Pjesa 2: “Rregulla të përbashkëta për Punën e Standardizimit”, 2011 që lidhen me notifikimin e EN-ve si S SH;
- Guida 12 e CEN/CENELEC “Koncepti i anëtarësisë në CEN dhe CENELEC”;
- Marrëveshja mbi respektimin e kushteve nga një anëtar pa të drejtë vote (affiliate) kur adopton një standard European (EN).

4. Termat e përdorur

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohen në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për Standardizimin”, amenduar me ligjin nr. 10384, datë 24.2.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870 “Për standardizimin””.

Notifikim: Në kuptimin e kësaj rregulloreje është procesi i kryer për njoftimin në CEN dhe CENELEC të të gjitha standardeve EN të adoptuara nga DPS si Standarde Shqiptare.

Shkurtime të përdorura

CEN: Komiteti European i Standardizimit

<i>CENELEC:</i>	Komiteti European i Standardizimit në fushën e elektroteknikës
<i>ISO:</i>	Organizmi Ndërkombëtar i Standardizimit
<i>DPS:</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
<i>OBT:</i>	Organizata Botërore e Tregtisë
<i>DIE:</i>	Drejtoria e Integritimit Evropian
<i>DeS:</i>	Drejtoria e Standardeve
<i>CMC:</i>	Qendra e Menaxhimit të CEN
<i>CS:</i>	Sekretariati Qendror i CENELEC
<i>SHSPR:</i>	Spektori i shitjes së standardeve dhe Pikë Referimi në OBT
<i>EN:</i>	Standard Evropian
<i>S SH:</i>	Standard Shqiptar

5. Përshkrimi

- a- DPS, bën çdo 6 muaj pranë CENELEC dhe minimumi çdo muaj pranë CEN notifikimin e punës së kryer në lidhje me adoptimet e EN-ve si S SH. Për këtë, Sekretarët e komiteteve teknike, pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm të EN-ve të adoptuara si S SH, i dërgojnë përgjegjësit të sektorit SHSPR në OBT një kopje të praktikës (vendimi, lista e standardeve të adoptuara, komentet e marra gjatë shqyrtimit të tyre, etj) me emërtim dokumenti sipas formatit të paracaktuar në procedurën e punës PO/DS/104. Përgjegjësi i Sektorit të SHSPR në OBT, sipas vendimeve të miratimit të standardeve, harton listat e standardeve EN të CEN-it dhe listën e standardeve EN të CENELEC-ut, duke përfshirë në këto lista gjithë standardet evropiane si S SH EN, S SH EN ISO, S SH HD (kjo e fundit vetëm për rastin e CENELEC-ut), datat e implementimit të tyre, si dhe të dhënat e tjera që kërkohen për hedhjen e tyre në database-in e CEN dhe CENELEC. Duhet theksuar se të dhënat e kërkuara për hedhje ndryshojnë në varësi të formatit të përcaktuar nga organizmat përkatës.
- b- Përgjegjësi i Sektorit të SHSPR në OBT bashkëpunon me Drejtorinë e Standardeve në lidhje me listat e standardeve EN, verifikon numrin e vendimeve të miratimit të EN-ve, i cili duhet të jetë në përputhje me numrin e vendimeve të marra me e-mail nga Sekretarët e Komiteteve Teknike përkatëse. Bashkëpunon me DeS për plotësimin e kërkesave specifike të këtyre listave siç është Short Project key në rastin e notifikimeve në CENELEC.
- c- Përgjegjësi i Sektorit të SHSPR në OBT pasi përgatit listën me standardet e adoptuara të CENELEC në formatin .txt , ja dërgon këtë listë për miratim Drejtorit të Përgjithshëm. Pasi merr miratimin nga Drejtori i Përgjithshëm, ja dërgon listën specialistit të Sektorit të Integritimit, Marrëdhënieve me Publikun, Marketing për të përgatitur link-un përkatës. Pasi merr link-un, Përgjegjësi ose specialisti i Pikës së Referimit në OBT e dërgon atë në adresën e mëposhtme:

Për njoftimet në CENELEC Helpdesk@cenelec.org

➤ **Formati i njoftimit në CENELEC**

Project short key#ISO cc#National ref#Date of publication at national level

➤ **Mesazhi i dërguar për notifikimin e standardeve EN të adoptuara si standarde shqiptare**

Dear Madam,

Please find attached the list of EN Standards (CENELEC) adopted as Albanian one from to200..at link

For any clarification, please do not hesitate to contact us again.

Regards,

Staff name
Specialist

Albanian General Directorate of Standardization
European Integration Department
WTO Enquiry Point
Tel: +355 (0) 4 22 62 55
Fax: +355 (0) 4 24 71 77
E-mail: dervishi.a@dps.gov.al
Web: www.dps.gov.al

Në faqen 4 jepet modeli i procesit të notifikimit të EN-ve të adoptuara si S SH.

Listat e standardeve të notifikuara si dhe korespondenca e kryer me e_mail ruhen në database_n e serverit të DPS-së.

d- Për notifikimin në CEN ndiqet procedura e i-Projex-it. Pasi përgatitet lista me standardet e reja të adoptuara në formatin e kërkuar excel, hyhet në faqen e internetit të Cen-it : <https://www.cen.eu/iProjex>, vendoset user name-i dhe password-i dhe bëhet upload-imi i listës në data basen e CEN-it.

➤ **Formati i njoftimit në CEN:**

NSB	DPS															
DATE																
VERSION	1															
EURKEY	3															
European standard reference	W.I. number	W.I. surrogate	Date of availability	Date of publication	DoW	Method of implementation	National standard reference	Date of publication NSR	Legal status	Available language	Reference of national official journal	Date of national official journal	National comment	Existing conflicting standard	WJOUR	WJOUR



